

V E N D I M
Nr. 376, datë 14.7.2000

PËR RRITJEN E PAGAVE TË GJYQTARËVE DHE TË PROKURORËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në nenit 4, të ligjit nr.7800, datë 2.3.1994, “Për pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë dhe prokurorëve”, ndryshuar me ligjin nr.8082, datë 7.3.1996, me propozimin e zëvendëskryeministrit e ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pagat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve rriten në masën 10 për qind, sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen në përputhje me pikën 1, të aktit normativ nr.1, datë 14.7.2000, “Për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga rritja e pagave dhe pensioneve”.
 3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1.7.2000.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

PASQYRA 1
PAGA MUJORE E PUNONJËSVE TË PROKURORIVE

1.1. Në Prokurorinë e Përgjithshme

1. Prokuror i përgjithshëm	91960 lekë
2. Prokuror i Gjykatës së Lartë	68970 “
3. Prokuror (drejtor drejtorie)	55363 “
4. Prokurorë të Prokurorisë së Përgjithsh.	52635 “

1.2. Në Prokurorinë e Apelit

1. Prokuror Apeli	55363 lekë
2. Zëvendësprokuror Apeli	52635 “
3. Prokuror	47190 “

1.3. Në Prokurorinë e rrethit Tiranë

1. Prokuror rrethi	52635 lekë
2. Zëvendës Prokuror rrethi	47190 “
3. Prokuror	43560 “
4. Oficer i policisë gjyqësore	37752 “

1.4. Në prokuroritë e rretheve

1. Prokuror rrethi	47190 lekë
2. Zëvendës Prokuror rrethi	43560 “
3. Prokuror	39930 “
4. Oficer i policisë gjyqësore	37510 “

PASQYRA 2
PAGA MUJORE E GJYQTARËVE

2.1. Në gjykatën e Apelit Civil dhe në Gjykatën Ushtarake të Apelit

1. Kryetar	68970 lekë
2. Zëvendëskryetar	57838 “
3. Gjyqtarë	54450 “

2.2. Në gjykatën e rrethit Tiranë

1. Kryetar	54450 lekë
2. Zëvendëskryetar	48103 “
3. Gjyqtarë	44473 “

2.3. Në gjykatat e rretheve

1. Kryetar	48103 lekë
2. Zëvendëskryetar	44473 “
3. Gjyqtarë	41745 “

PASQYRA 3
PAGAT E INSPEKTORIATIT PRANË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

3.1. Kryeinspektorë dhe inspektorë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë

1. Kryeinspektor	68970 lekë
2. Zëvendëskryeinspektor	57838 “
3. Inspektor	54450 “